



## Termet e Referencës (ToR)

Prokurimi për: **Vlerësimi i aftësive dhe identifikimi i nevojave për trajnim për gratë, të rinjtë dhe fermerët e vegjël**

“Forcimi i Sektorit të Qumështit në Kosovë: Produktiviteti, Cilësia e Qumështit dhe Qëndrueshmëria Klimatike (Faza II)”

### I.Konteksti

Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK) është një organizatë lokale jofitimprurëse e themeluar në vitin 2005 për të përfaqësuar interesat e fermerëve në mbarë Kosovën, me fokus të veçantë te fermerët e blegtorisë dhe qumështit. Me mbi 19 vjet përvojë, SHPQK është një organizatë e njohur dhe e respektuar gjerësisht në rrethin e akterëve bujqësorë të sektorit publik dhe privat në Kosovë, gjë që e bën atë një partner të vlefshëm të institucioneve qeveritare lokale e qendrore, si dhe subjekteve të tjera, veçanërisht organizatave ndërkombëtare.

### Aktivitetet Kyçe të SHPQK-së

Për të arritur këto objektiva, aktivitetet kryesore të SHPQK-së përfshijnë:

- Konsulencë e rregullt dhe ofrim i ekspertizës për zgjerimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të fermerëve blegtoralë (veçanërisht sa i përket shkathtësive teknike dhe atyre për menaxhimin e fermës);
- Ofrimi i ekspertizës teknike në hartimin dhe zhvillimin e politikave bujqësore në nivel kombëtar (veçanërisht për skemat e pagesave direkte dhe granteve për investime), si dhe për ligjet dhe standardet kombëtare që lidhen me nënsektorin e blegtorisë;
- Ofrimi i informacioneve të rregullta për fermerët ekzistues anëtarë të shoqatës mbi gjendjen e cilësisë së qumështit të tyre dhe masat e nevojshme për përmirësimin e kushteve higjienike, me qëllim rritjen e cilësisë dhe të kapacitetit prodhues;
- Ofrimi i informatave të përgjithshme mbi zhvillimet e tregut në nënsektorin e blegtorisë;
- Avokimi dhe përfaqësimi i interesave të fermerëve blegtoralë pranë institucioneve qeveritare dhe akterëve të tjerë relevantë.

Projekti: "Fuqizimi i Sektorit të Qumështit në Kosovë"

Projekti “**Fuqizimi i Sektorit të Qumështit në Kosovë: Produktiviteti, Cilësia e Qumështit dhe Rezistenca ndaj Klimës (Faza II)**” (2025–2028) synon të rrisë produktivitetin, cilësinë e qumështit, qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në zinxhirin e vlerës së qumështit në Kosovë.



Përkundër progresit të arritur, gratë, të rinjtë dhe fermerët e vegjël mbeten të kufizuar nga:

- Qasja e kufizuar në trajnime teknike dhe biznesore;
- Aftësitë e dobëta në agrobiznes dhe në menaxhim financiar;
- Pjesëmarrja e ulët në procesim dhe në rritjen e vlerës së produkteve (përpunim);
- Qasja e kufizuar në tregje dhe në mundësi sipërmarrëse;
- Barrierat gjinore dhe gjeneratave në proceset e vendimmarrjes.

Për të adresuar këto sfida, SHPQK do të realizojë një **Vlerësim Gjithëpërfshirës të Shkathtësive dhe Analizë të Nevojave për Trajnim (TNA)**, për të siguruar që aktivitetet e ardhshme për ngritjen e kapaciteteve të jenë të përshtatura, gjithëpërfshirëse dhe t'u përgjigjen nevojave reale.

## II. Qëllimi i Detyrës

Qëllimi i këtij angazhimi është që të:

- Vlerësojë kapacitetet aktuale teknike, menaxhuese dhe ndërmarrëse të grave, të rinjve dhe fermerëve të vegjël.
- Identifikojë mangësitë në njohuri në prodhimin e qumështit, përpunimin dhe agrobiznesin.
- Analizojë barrierat për pjesëmarrje në sisteme ushqimore gjithëpërfshirëse.
- Ofrojë rekomandime të bazuara në dëshmi për hartimin e programeve të synuara të trajnimit.

Ky vlerësim do të sigurojë që aktivitetet e ardhshme trajnuese (Aktiviteti 2.1.2 dhe 2.1.3) të jenë praktike, të bazuara në kërkesë, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të harmonizuara me realitetet e tregut.

## III. Objektivat e Vlerësimit të Shkathtësive

Objektivat specifike janë që të:

- Identifikojë shkathtësitë ekzistuese në:
  - Prodhimin e qumështit (ushqyerja, higjiena, rritja/mbarështimi, menaxhimi i fermës)
  - Përpunimin e qumështit dhe rritjen e vlerës së produktit
  - Planifikimin e biznesit dhe njohuritë financiare (literatuta financiare)
  - Marketingun dhe qasjen në treg
  - Njohuritë digjitale (platformat celulare, mbajtja e të dhënave/shënimeve)
- Identifikojë mangësitë në kapacitete te:
  - Gratë fermere
  - Të rinjtë (15–29 vjeç)
  - Fermerët e vegjël të qumështit
- Vlerësojë kufizimet (pengesat) që limitojnë pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në zinxhirët e vlerës së qumështit.
- Rekomandojë module trajnimi të përshtatura, të diferencuara sipas:
  - Gjinisë



- Grupit moshës
- Madhësisë së fermës
- Nivelit të përvojës

#### **IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë**

Kompania ose konsulenti do të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

##### **4.1 Rishikimi i Dokumentacionit**

- Rishikimi i dokumenteve të projektit dhe të dhënave fillestare (baseline data).
- Analizimi i raporteve ekzistuese nga SHPQK (KAMP), donatorët e tjerë dhe studimet e sektorit.
- Rishikimi i kornizave kombëtare për trajnimet bujqësore.

##### **4.2 Zhvillimi i Mjeteve të Vlerësimit**

- Hartimi i pyetësorëve të strukturuar (sasi/kuantitativ).
- Përgatitja e udhëzuesve për intervista (cilësor/kualitativ).
- Sigurimi që mjetet e vlerësimit të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe gjithëpërfshirëse për të rinjtë.

##### **4.3 Mbledhja e të Dhënave në Terren**

- Realizimi i anketave me të paktën 20 fermerë të qumështit në mbarë Kosovën.
- Organizimi i:
  - Intervistave me Informatorët Kyç (stafi i SHPQK, përpunuesit, përfaqësuesit e MCP-së).
- Sigurimi i pjesëmarrjes minimale prej 30% gra dhe 30% të rinj.

##### **4.4 Analiza e të Dhënave**

- Analizimi i të dhënave sasiore dhe cilësore.
- Identifikimi i mangësive kryesore në shkathtësi sipas kategorive.
- Identifikimi i variacioneve rajonale.
- Vlerësimi i vullnetit për të marrë pjesë në trajnimet e ardhshme.

##### **4.5 Korniza e Nevojave për Trajnim**

Zhvillimi i një plani të strukturuar trajnimi që specifikon:

- Temat prioritare.
- Nivelin (fillestar, i mesëm, i avancuar).
- Kohëzgjatjen.
- Metodologjinë e rekomanduar (punëtori, mentorim/coaching, mësimi nga bashkëmoshatarët).
- Strategjitë e ndjeshme ndaj gjinisë.



## **V. Fushat Kyçe të Vlerësimit**

Vlerësimi duhet të ekzaminojë fushat e mëposhtme të kompetencës:

### **A. Shkathtësitë Teknike të Prodhimit**

- Ushqyerja dhe përgatitja e silazhit
- Praktikrat bujqësore të përshtatura ndaj klimës
- Higjiena e qumështit dhe kontrolli i cilësisë
- Njohuritë bazë mbi shëndetin e kafshëve
- Menaxhimi i plehut organik

### **B. Përpunimi dhe Rritja e Vlerës**

- Përpunimi i qumështit në shkallë të vogël
- Diversifikimi i produkteve (djathë, jogurt, etj.)
- Standardet e sigurisë ushqimore

### **C. Shkathtësitë e Biznesit dhe Agrobiznesit**

- Llogaritja e kostos së prodhimit
- Mbajtja e shënimeve (rekordeve) të fermës
- Buxhetimi dhe njohuritë financiare
- Planifikimi i biznesit
- Qasja në financa

### **D. Udhëheqja dhe Shkathtësitë Organizative**

- Pjesëmarrja në organizatat e fermerëve
- Shkathtësitë e komunikimit
- Vendimmarrja
- Mundësitë e ndërmarrësisë për të rinjtë

## **VI. Metodologjia**

Konsulenti duhet të zbatojë një qasje me metoda të ndërthurura duke përfshirë:

- Anketa sasiore (kuantitative)
- Matricën e vetëvlerësimit të shkathtësive
- Kornizën e analizës gjinore

Metodologjia duhet të sigurojë:

- Zë të barabartë të pjesëmarrëseve gra
- Hapësira diskutimi të sigurta dhe gjithëpërfshirëse
- Qasje të angazhimit të përshtatshme për të rinjtë
- Respektimin e Qasjes së Bazuar në të Drejtat e Njeriut



## VII. Produktet e Pritshme (Deliverables)

Konsulenti/ekipi duhet të dorëzojë:

- Raportin Final të Vlerësimit të Shkathtësive, i cili përfshin:
  - Përmbledhje ekzekutive
  - Gjetjet e detajuara
  - Matricën e nevojave për trajnim
  - Rekomandime për dizajnimin e mentorimit
  - Shtojcat (mjetet e përdorura, përmbledhja e të dhënave bruto)

Raporti final duhet të përgatitet në gjuhën angleze dhe shqipe.

## VIII. Kohëzgjatja e Detyrës

Detyra pritet të zgjasë 4 javë, e strukturuar si vijon:

- **Java 1:** Rishikimi i dokumentacionit dhe zhvillimi i mjeteve të vlerësimit.
- **Java 2:** Mbledhja e të dhënave në terren.
- **Java 3:** Analiza e të dhënave dhe draft-raporti.
- **Java 4:** Finalizimi dhe prezantimi.

## IX. Kualifikimet e Kërkuara

Konsulenti/ekipi duhet të ketë:

- Të paktën 3 vjet përvojë në analizën e zinxhirit të vlerës bujqësore ose zhvillimin rural.
- Përvojë të dëshmuar në vlerësimin e nevojave për trajnim.
- Kuptim të fortë të sistemeve të prodhimit të qumështit.
- Përvojë në analizën gjinore dhe përfshirjen e të rinjve.
- Shkathtësi të forta analitike dhe të shkrimit të raporteve.

## X. Raportimi dhe Mbikëqyrja

Kompania/konsulenti do t'i raportojë:

- **Menaxherit të Projektit – SHPQK (KAMP)**

Të gjitha produktet duhet të aprovohen nga SHPQK para pranimit final.

## XI. Udhëtimet zyrtare dhe akomodimi

Të gjitha kostot e transportit dhe shpenzimet e tjera mbulohen nga kompania/konsulenti ofertues.



## XII. Kushtet e pagesës

- Pagesa do të bëhet pas aprovimit të të gjithë kompletit të dokumenteve.
- Pagesat do të realizohen bazuar në kërkesën e dërguar përmes e-mailit në: shpqkkamp@gmail.com, milazimmakolli@gmail.com.

## XIII. Procedura e aplikimit

Deri më **16 mars**, të gjithë konsulentët/kompanitë e interesuara duhet të dërgojnë aplikimin e tyre në: shpqkkamp@gmail.com, info@shpqk.org. E-maili duhet të përfshijë një CV të stafit të përfshirë, Referencat, Ofertën Financiare dhe Deklaratën e Marrëdhënieve.

- **Deri më 17 mars:** do të bëhet vlerësimi i ofertave dhe nënshkrimi.
- **Deri më 18 mars:** kontrata do të nënshkruhet nga të dyja palët.

## XIV. Vlerësimi i Ofertave

Aplikimet e paplotësuara ose ato që pranohen pas afatit nuk do të merren parasysh. Vlerësimi do të bazohet në parimin "vlera më e mirë për paratë" (80% kualifikimi teknik, 20% propozimi financiar).

### Vlerësimi Teknik (60%):

- **Edukimi (max 30%):**
  - Diplomë Bachelor (20%),
  - Diplomë Master (30%) në shkencat bujqësore ose agroekonomike.
- **Përvoja relevante (max 30%):**
  - 3 vjet (10%),
  - 3-5 vjet (20%),
  - mbi 5 vjet (30%).

Vetëm ata që arrijnë pragun prej 50% të kualifikimit teknik do të kalojnë në vlerësimin financiar.

**Vlerësimi Financiar (40%):** Bazuar në formulën:  $40 * (\text{Çmimi më i ulët} / \text{Çmimi i propozuar})$ .

## XV. Deklarata e marrëdhënieve

Aplikuesi duhet të përshkruajë nëse organizata/punonjësit e tyre kanë ndonjë marrëdhënie biznesi ose personale me palë të lidhura ngushtë nga We Effect, Zyra Rajonale në Shkup, organet e saj drejtuese dhe punonjësit. Qëllimi i kësaj deklarate është zbulimi i informacioneve që e bëjnë procesin e aplikimit dhe vlerësimit më transparent.